



VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 14.09.2011

Nr. i rastit: 2011-02

Chamalagai Krishna Bahadur dhe të tjerët

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 14 shtator 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

PROCEDURAT

1. Ankesa është regjistruar më 13 janar 2011. Paneli ka kërkuar informatë shtesë nga parashtuesi i ankesës më 9 shkurt 2011. Ajo informatë ishte pranuar më 11 shkurt 2011.
2. Me 23 shkurt 2011 Paneli ka vendosur që ta njoftoj Shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it në Kosovë rreth kësaj ankese, duke e ftuar atë që të dorëzoj vërejtje me shkrim lidhur me pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e ankesës. U vendos që të shqyrtohet bazueshmëria

si dhe pranueshmëria e ankesës (Rregullorja 30, paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores së Punës së Panelit, më tutje: RrP).

3. Më 24 prill 2011 dhe më 16 qershor 2011, Sekretariati ka paraqitur një kërkesë për informatë tek Gjykata Kushtetuese e Kosovës për të vendosur statusin e rastit të parashtruesve të ankesës. Më 20 qershor 2011, Gjykata Kushtetuese ka njoftuar Panelin se rasti do të shqyrtohej në korrik 2011. Në përgjigjen që iu dha pas pyetjes tjetër nga Sekretariati, Gjykata Kushtetuese ka deklaruar në gusht 2011 se rasti do të shqyrtohej në sesionin e shtatorit.
4. Vërejtjet e ShM janë pranuar më 21 korrik 2011. Ato vërejtje iu janë dorëzuar parashtruesit të ankesës për t'i paraqitur vërejtjet e tij.
5. Më 17 gusht 2011, njëri prej parashtruesve të ankesës njoftoj Sekretariatit se parashtruesit e ankesës që janë ende në Kosovë do të largohen nga Kosova të nesërmen në mëngjes. Nuk janë pranuar vërejtje të tjera nga parashtruesi i ankesës.

FAKTET

I. RRETHANAT E RASTIT

6. Faktet e rastit të paraqitura nga palët mund të përmbliidhen si më poshtë.

Informatë

7. Parashtruesit e ankesës janë katër (4) shtetas të huaj (nga Nepali). Parashtruesi i parë ka mbërritur në Kosovë në pjesën e dytë të vitit 2009. Ai kishte regjistruar një kompani të quajtur "*Goodmorning Global*" dhe kishte filluar të udhëheq restorantin "*Mount Everest Restaurant*" në Prishtinë. Më pas, parashtruesi i parë i ankesës kishte parashtruar kërkesë për leje që t'i sjellë dy persona të tjerë në Kosovë si punëmarrës në kompani. Ata arritën më 31 maj 2010.
8. Në korrik 2010, parashtruesi i parë i ankesës kishte mbyllur restorantin pasi qiraja ishte shumë e lartë. Ishte vendosur që të hapej një restorant i ri në bashkëpunim me pesë persona në një vend të ri. Parashtruesi i parë i ankesës dhe të dy punëmarrësit-partnerët kishin hyrë në një kontratë të qirasë me pronarin e lokalit të ri për pesë vite. Ata kishin importuar pajisje të domosdoshme nga India për restorantin me vlerë prej 3,000 eurosh (EUR). Përafërsisht 1,000 euro ishin paguar për zhdoganimin e pajisjeve. Restoranti i ri ishte hapur me emrin "*Bollywood Restaurant*". Emri i ri dhe vendi i restorantit ishin regjistruar në Agjensionin Kosovar për Regjistrimin e Bizneseve më 20 gusht 2010 si pronë e kompanisë "*Goodmorning Global*".
9. Parashtruesit e ankesës deklarojnë se ata kanë investuar mbi 30,000 euro në restorantin e tyre. Ata deklarojnë se kanë përmbushur të gjitha detyrimet e tyre ligjore në fuqi me ligjet e Kosovës. Ata kanë

ofruar dokumentacionin që ka të bëjë me regjistrimin e kompanisë së tyre, dokumentet fiskale si dhe faturat e pagesave të taksave të ndryshme dhe kështu e pensionit.

Vlefshmëria e lejeve të parashtruesve të ankesës

10. Në kohën e paraqitjes së ankesës së tyre tek Paneli në janar të vitit 2011, parashtruesit e ankesës kishin këto vendbanime dhe leje të paraqitura si në vijim:
 1. Sitaram Chaulagai, shtetas i Nepalit, letërnjoftim të Kosovës të vlefshëm deri 23 tetor 2010, leje të punës "D" me numër të protokollit 89 të vlefshëm deri më 12 prill 2011;
 2. Chandra Chauhan, shtetase e Nepalit, letërnjoftimi i Kosovës e vlefshme deri më 23 tetor 2010;
 3. Krishna Chamlagai, shtetas i Nepalit, letërnjoftimi i Kosovës i vlefshëm deri më 1 prill 2011, leja e punës "B" numri i protokollit 90, e vlefshme deri më 12 prill 2011; dhe
 4. Hom Bhattarai, shtetas i Nepalit, letërnjoftim i Kosovës i vlefshëm deri më 1 prill; 2011, leja e punës "B" numri i protokollit 93 i vlefshëm deri më 12 prill 2011.

Kontaktet me policinë e imigracionit në tetor 2010

11. Më 28 shtator 2010, parashtruesi i tretë i ankesës kishte vizituar zyrën për imigracion për t'i paraqitur të gjitha dokumentet e nevojshme për ta marrë lejen për hyrje të gruas së tij dhe një personi tjetër në Kosovë. Ai ishte urdhëruar që të vinte në zyrën për imigracion pas 10 ditësh.
12. Më 4 tetor 2010 Policia e Kosovës ka ndërmarrë një hetim në adresën e regjistruar të kompanisë "*Goodmorning Global*". Sipas raportit policor të përgatitur më pas, asnjë veprimtari biznesi nuk zhbillohej në atë adresë, ku aty kishte vetëm dhoma banimi. Policia gjithashtu kishte inspektuar lokacionin e restorantit të parë si dhe lokacionin e restorantit të dytë, i cili nuk ishte hapur ende. Policia kishte pranuar një raport nga Inspektorati tatimor në Ministrinë për Tregti dhe Industri duke paraqitur se kompania nuk kishte bërë asnjë transaksion, detyrime apo pagesa dhe në të vërtetë dukej se ajo nuk ka funksionuar fare.
13. Më 5 tetor 2010 policia kishte ftuar të tre partnerët (parashtruesit e ankesës 1, 2 dhe 3) për të raportuar në zyrën e imigracionit për një intervistë në lidhje me ftesat e partnerëve të rinj në Kosovë. Pasaportat dhe letërnjoftimet e parashtruesve të ankesës ishin konfiskuar nga policia dhe atyre iu ishte kërkuar që të nënshkruajnë dokumente të caktuara në gjuhën shqipe pa ditur kuptimin.
14. Më 6 tetor 2010 parashtruesit e ankesës kishin raportuar tek zyra e imigracionit. Në këtë rast, atyre iu ishin marrë lejet e punës.
15. Vetëm pas disa ditëve më vonë parashtruesit e ankesës kishin zbuluar se dokumeteenti që ata kishin nënshkruar gjatë vizitës së tyre

në stacionin policor më 5 tetor 2010 deklaronte se ata ishin duke qëndruar në Kosovë në mënyrë të jashtëligjshme. Ata ishin kthyer në stacionin policor për të pyetur rreth dokumentit. Ata i deklaruan zyrtërve policorë se ata kishin leje të vlefshme për të qëndruar në Kosovë dhe kanë treguar se ato leje tashmë iu ishin konfiskuar nga policia.

Kontaktet me Institucionin e Avokatit të Popullit dhe me një avokat

16. Parashtruesit e ankesës më pas kanë kontaktuar me Institucionin e Avokatit të Popullit. Ata ishin këshilluar që të kontaktojnë Qendrën për Ndhimë Ligjor dhe Zhvillim Rajonal. Parashtruesit e ankesës kishin kontaktuar një avokat, i cili i kishte njoftuar ata se do të bisedoj me zyrtarët policor pasi ata ishin shokët e tij.

Procedurat lidhur me ndërprerjen e lejeve të qëndrimit

17. Më 26 tetor 2010 Komisioni për Shqyrtimin e Lejeve të Përkohshme dhe të Përhershme të Ministrisë së Punëve të Brendshme kanë vendosur që të tërheqin lejet e përkohshme të qëndrimit që iu ishin lëshuar të tre parashtruesve të ankesës. Baza ligjore për këtë vendim ishte Neni 46, paragrafi 1, pika 1.2, 1.3 dhe Neni 47, paragrafi 1, pika 1.2 e Ligjit mbi të huajt nr. 03/L-126 dhe Neni 21 i Udhëzimit Administrativ nr. 01/2010-MPB rreth Themelimit të Komisionit për Shqyrtim dhe Komisionin për Ankesa. Është vënë në dukje se ai vendim ishte bazuar në raportin e policisë të 4, 5 dhe 6 tetorit 2010, të cilët kishin paraqitur se kompania nuk ishte funksionale. Një urdhër për dëbim ishte kërkuar ndaj parashtruesve të ankesës.
18. Më 30 nëntor 2010, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të të Huajve në Ministrinë e Punëve të Brendshme kishte vërtetuar vendimin e komisionit që t'i tërheq lejet. Parashtruesit e ankesave kishin afat 30 ditë që të apelonin tek Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës prej kohës kur iu ishte dorëzuar vendimi. Parashtruesit e ankesës pohojnë se vendimi i shkallës së parë asnjëherë nuk iu kishte dorëzuar atyre, dhe prandaj ata nuk kishin mundur që të apelojnë atë tej Gjykata Supreme.

Procedurat në lidhje me ndërprerjen e lejeve të punës

19. Më 29 tetor 2010, Drejtori i Departamentit të Punës dhe Punësimit në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale kishte ndërprerë lejet e punës për shkak të prishjes së lejeve të tyre të qëndrimit më 26 tetor 2010 (shih më lart paragrafin 16).

Procedurat në lidhje me urdhrin për tu larguar nga Kosova

20. Më 1 nëntor 2010 policia kishte ftuar në stacionin policor parashtruesit e ankesës. Atyre iu ishin kthyer pasaportat dhe ishin urdhëruar që të largohen nga Kosova jo më vonë se 6 nëntori 2010, në bazë të një vendimi nga Shefi i Departamentit të Policisë Kufitare të datës 1 nëntor 2010.

21. Parashtruesit e ankesës kishin afat tetë (8) ditë për të apeluar kundër vendimit, ku ishte e caktuar data e largimit nga vendi. Ankesa kundër vendimi nuk mund ta pezullonte vendimin.
22. Parashtruesve të ankesës iu ishte thënë që ata mund të përballen me arrestim dhe me largim të dhunshëm nga Kosova nëse nuk do të largohen vullnetarisht nga Kosova. Parashtruesit e ankesës më tej pohojnë se iu ishte kërkuar që të nënshkruajnë një dokument të paidentifikuar. Ata nuk kishin pranuar që të nënshkruajnë. Përkundër kërkesave të tyre, atyre nuk iu ishte dhënë asnjë arsye për dëbimin e tyre nga Kosova.
23. Në mesditën e 2 nëntorit 2010 parashtruesit e ankesës vizituan stacionin policor me një avokat tjetër pasi avokati i tyre i mëhershëm kishte refuzuar t'iu përgjigjej thirrjeve të tyre. Sipas memorandumit policor të përpiluar atë ditë, parashtruesit e ankesës refuzun që t'i merrnin pasaportat e tyre dhe i kishin rezistuar dëbimit nga vendi. Policia ka konsideruar se kjo sjellje ka tregur se ata kanë refuzuar t'i zbatojnë ligjet e Kosovës.
24. Si pasojë e kësaj rezistence, procedurat penale lidhur me një qëndrim joligjor në Kosovë kishin filluar kundër parashtruesve të ankesës në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje më 8 nëntor 2010.
25. Më 9 nëntor 2010, Gjykata për Kundërvajtje ka gjetur se parashtruesit e ankesës kishin qëndruar në Kosovë në mënyrë jo të ligjshme pa leje qëndrimi, përkundër faktit se urdhri për dëbim ishte lëshuar më 1 nëntor 2010. Ata ishin gjobitur në përputhje me Nenin 53.2, Nenin 55 dhe 58, Pika 1.2 dhe 3 e Ligjit për të Huaj 03/L-126, dhe Neni 2.al.1 i Udhëzimit Administrativ 19/2009-MIA, bazuar në Nenin 73, 74, 195 dhe 199 të Ligjit për Kundërvajtje GZ.KSAK nr. 23/79.
26. Gjobat ishte dashur që të paguheshin brenda 15 ditësh nga dita kur ky vendim të merrte formën përfundimtare. Në rast se nuk bëhej pagesa, parashtruesit e ankesës do të ballafaqoheshin me burgosje. Gjithashtu ata ishin urdhëruar që menjëherë të largohet nga Kosova dhe iu ishte ndaluar hyrja në vend brenda dy viteve.
27. Më 22 nëntor 2010, Gjykata e Lartë për Kundërvajtje ka vërtetuar vendimet e gjykatës më të ulët të datës 9 nëntor 2010 dhe ka urdhëruar parashtruesit e ankesës që menjëherë të largohen nga Kosova. Me ligj nuk ka të drejtë ankese kundër këtij vendimi.
28. Më 3 dhjetor 2010, parashtruesit e ankesës kërkuann një masë të përkohshme ndaj urdhrit për dëbim tek Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Më 13 dhjetor 2010, gjykata kishte miratuar kërkesën deri në një njoftim tjetër. Tani për tani rasti është ende i pazgjidhur pranë Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafin 3 më lart).

Procedurat në vazhdim

29. Më 5 janar 2011, policia e imigracionit kishte thirrur parashtruesin e parë të ankesës dhe e kishte ftuar atë të paraqitet në stacionin policor. Në stacionin policor, parashtruesit të ankesës i ishte thënë që të largohet nga Kosova brenda tre ditësh. Nuk ishte dhënë asnjë arsye.
30. Më 19 janar 2011, siç duket herët në mëngjes, pesë policë kishin arritur tek shtëpia e parashtruesve të ankesës me furgon dhe iu kishin thënë atyre që të vishen dhe të shkonin në një seancë dëgjimore në Gjykatën për Kundërvajtje. Njëra prej parashtruesve të ankesës nuk kishte shkuar, pasi në atë kohë ishte shtatzënë në muajin e 8.
31. Parashtruesit e ankesës deklarojnë e një përkthyes i cili ishte i pranishëm në gjykatë, iu kishte thënë atyre se ata duhet të zgjedhin të paguanin 370 euro apo të burgoseshin. Nga dokumentet e paraqitura nga parashtruesit e ankesës del se gjobat në tre raste prej 100 eurosh dhe një prej 50 eurosh lidhur me shkeljet individuale në trafik ishin paguar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Kontaktet me EULEX-in

32. Më 3 nëntor 2010 dhe sërish më 5 janar 2011, parashtruesit e ankesës kishin komunikuar me EULEX-in përmes postës elektronike. Parashtruesit e ankesës kishin shpjeguar gjendjen e tyre dhe kishin vënë në dukje se para se të fillonin të gjitha procedurat ndaj tyre ata ishin paralajmëruar nga së paku dy nepalez se nuk duhet ta hapnin ndonjë restorant indian në Prishtinë, pasi “nuk është mirë për ta”.
33. Në përgjigje, parashtruesit e ankesës ishin këshilluar nga zyra e Shefit të Personelit të EULEX-it në Kosovë që të kontaktojnë një avokat privat të kualifikuar për këshilla rreth mjeteve juridike civile që janë në dispozicion për ta dhe për të paraqitur ankesë pa vonesë të mëtejme tek organi kompetent administrativ apo tek Gjykata Supreme.

II. LIGJI NË FUQI

Veprimi i përbashkët për EULEX-in në KOSOVË

34. Nenet 2 dhe 3 të Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i në KOSOVË (më tutje si: Veprimi i Përbashkët), për pjesët e saj përkatëse thotë si në vijim:

Neni 2 Deklarata e Misionit

EULEX-i në Kosovë do të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjensionet për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies, dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumetnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor, duke siguruar se këto institucione nuk iu nënshtrohen ndërhyrjeve politike dhe i përmbahen standardeve të njohura ndërkombëtarisht dhe praktikave më të mira evropiane.

EULEX-i në KOSOVË, në bashkëpunim të plotë me Programin për Ndhimë të Komisionit Evropian, do ta përmbushë mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, duke ruajtur përgjegjësi të caktuara ekzekutive.

Neni 3 Detyrat

Në mënyrë që të përmbushet Deklarata e Misionit e përcaktuar në Nenin 2, EULEX-i në Kosovë do të:

- (a) monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet kompetente të Kosovës në të gjitha fushat që ndërlidhen me sundimin e ligjit (përfshirë shërbimin doganor), përdërisa i ruan disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive;
- (b) sigurojë ruajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, të rendit publik dhe të sigurisë, sipas nevojës, në konsultim me autoritetet përkatëse civile ndërkombëtare në Kosovë, nëpërmjet kthimit ose pezullimit të vendimeve operative të marra nga autoritetet kompetente të Kosovës.
- (c) ndihmojë për të siguruar se të gjitha shërbimet e sundimit të ligjit në Kosovë, përfshirë shërbimet doganore, nuk janë të ndikuara p[politikisht
...
- (e) kontribuon në forcimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit në tërë procesin gjyqësor, sidomos në fushën e krimit të organizuar;
- (f) kontribuon në luftën kundër korrupsionit, mashtrimit dhe krimit financiar;
...
- (i) sigurojë që të gjitha veprimet e tij i përmbahen standardeve ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.

LIGJI

I. SHKELJE E SUPOZUAR E KONVENTËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE

A. Ankesat

- 35. Parashtruesit e ankesës pretendojnë se ka shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ, 1950). Ata i referohen Nenit 6 (e drejta për proces të rregullt), Nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive), Protokollin nr. 7 (garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve).
- 36. Parashtruesit e ankesës pretendojnë se dokumentet e tyre të udhëtimit u morën prej tyre dhe ata janë të detyruar të largohen nga Kosova, duke lënë prapa tërë pasurinë e tyre, pavarësisht nga ajo se ata janë qytetarë që i binden ligjit.
- 37. Dispozitat përkatëse të Konventës vijon si më poshtë:

Neni 6 E drejta për një proces të rregullt

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj...

Neni 13 Zgjidhe efektive

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushjen të funksioneve të tyre zyrtare.

Protokolli nr. 1

Neni 1 Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveç për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i vlerësojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

Protokolli nr. 7

Neni 1 Garancitë procedurale

Garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve

1. Një i huaj me qëndrim të rregullt në territorin e një Shteti nuk mund të dëbohet, veçse në zbatim të një vendimi të marrë në përputhje me ligjin dhe duhet të ketë mundësi:

- (a) të parashtrijë arsyet kundër dëbimit të tij,
- (b) të kërkojë shqyrtimin e çështjes së tij, dhe
- (c) të përfaqësohet për këto qëllime përpara autoritetit kompetent ose një ose disa persona të caktuar nga ky autoritet.

2. Një i huaj mund të dëbohet përpara ushtrimit të të drejtave të renditura në paragrafin 1 (a), (b) dhe (c) të këtij neni, kur ky dëbim është i domosdoshëm në interes të rendit publik ose është bërë për arsye të sigurisë kombëtare.

B. Dokumentet e dorëzuara nga palët

Komentet nga ShM të EULEX-it në Kosovë

- 38. Në dokumentet e tij rreth bazueshmërisë së ankesës, ShM argumenton se rrethanat e ankesës nuk bien në kuadër të “ushtrimit të mandatit ekzekutiv” të EULEX-it në Kosovë.
- 39. Sipas tij, Komponenti i policisë, në përgjithësi, nuk është i autorizuar të përdor fuqinë ekzekutive. Policia e EULEX-it ruan një kapacitet korigjues, e cila e cila është një formë e veçantë e kompetencave ekzekutive. Kompetenca të tilla mund të përdoren gjatë ndonjë shkeljeje të të drejtave të njeriut dhe vendimeve jo të dhura operacionale apo administrative të marra nga Policia e Kosovës.
- 40. ShM argumenton më tej se Komponenti i Drejtësisë së EULEX-it nuk ka mandat ekzekutiv sa i përket procedurave juridike të kryera nga gjykatat më poshtë se niveli i Gjykatës së Qarkut. Në këtë ankesë, procedurat janë kryer në një nivel më të ulët, kryesisht në gjykatat komunale për kundërvajtje. Gjithashtu EULEX-i nuk ka mandat në lidhje me Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.
- 41. Për më tepër, ShM ka paraqitur se Njësia Monitoruese e EULEX-it në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme ka kompetenca zëvendësuese, një formë e veçantë e kompetencave ekzekutive, atëherë kur kërkohet nga ShM. Sidoqoftë, në këtë rast nuk është përdorur ndonjë kompetencë e tillë.

42. ShM argumenton se veprimet dhe masat e kontestuar nga parashtruesit e ankesës janë marrë nga Policia e Kosovës, Zyra për Imigracion e Kosovës, Komisioni për Shqyrtimin e Lejes së Përkohshme dhe të Përhershme të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës dhe nga gjyqësori i Kosovës. Asnjëra prej këtyre veprimeve që kanë të bëjnë me këtë ankesë nuk mund t'i vishet EULEX-it sa i përket kapacitetit të tij ekzekutiv.

Komentet nga parashtruesi i ankesës

43. Parashtruesit e ankesës nuk iu kanë përgjigjur vërejtjeve të ShM. Sipas njoftimeve të marra nga Sekretariati i Panelit, ata janë larguar nga Kosova.

C. Vlerësimi i Panelit

44. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos se a do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriterin për pranueshmëri të përcaktuar në Rregulloren 29 të Rregullores së Punës (RrP).
45. Paneli mund të shqyrtoj vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave, siç është saktësuar në Rregullin 25, paragrafi 1 i Rregullores së Punës.
46. Paneli vëren se ankesa ka të bëjë me procedura që janë kryer nga autoritetet e Kosovës, sa i përket qëndrimit të parashtruesve të ankesës në vend dhe lejeve të tyre të punës. Të gjitha vendimet dhe veprimet në fjalë janë kryer nga autoritetet apo gjyqësori i Kosovës.
47. Duke marrë parasysh të gjitha faktet në këtë rast, çështjet e ngritura në këtë ankesë nuk bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë. Fakti se parashtruesi i ankesës ka kontaktuar me EULEX-in në Kosovë për tu këshilluar nuk e vë këtë rast në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë.

PËR KËTO ARSYE, Paneli njëzëri,

konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, *gjen* se ankesa është e pabazuar sa i përket Nenit 29 (d) të Rregullores së Punës së vet, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit